

Raporti i ekipit të Auditimit Social në Drenas

Projekti i monitoruar “Ndërtimi i kolektorëve për grumbullimin e ujërave të zeza në Komunën e Drenasit – Projekti dyvjeçar”

Ky raport është përgatitur nga projekti DEMOS, zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation Kosovo.

Mohim: Gjetjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian, Zvicrës, Suedisë dhe Norvegjisë.

DEMOS dhe qëllimi i projektit

Projekti për Decentralizimin dhe Përkrahjen e Komunave (DEMOS) mbështet 38 komuna të Republikës së Kosovës në arritjen e qeverisjes lokale më demokratike dhe menaxhimit më të mirë komunal. Projekti DEMOS gjithashtu mbështet Qeverinë e Kosovës në zhvillimin e politikave, të cilat janë më të favorshme për financim të bazuar në rregulla për komunat.

Projekti DEMOS aktualisht është në fazën e tretë (2022-2025) duke u mbështetur në sukseset e arritura që nga fillimi i projektit në vitin 2014. Projekti bashkëfinanohet nga Bashkimi Evropian në Kosovë, Zvicra, Suedia dhe Norvegjia dhe zbatohet nga Helvetas Swiss Intercooperation Kosovë.

Mbështjeta e DEMOS për komunat e Kosovës është në kuadër të Grantit të Performancës si njëri nga mjetet që garanton përkrahje për komunat me performancë të mirë.

Performanca komunale vlerësohet përmes Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK) të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).

Me qëllim të rritjes së performancës në indikatorë të caktuar, DEMOS ofron edhe asistencë teknike për komunat. Një fokus i veçantë i projektit është edhe përkrahja për qeverinë qendrore ku DEMOS është i fokusuar në ofrimin e asistencës në ndërtimin e politikave për një kornizë më të favorshme për qeverisje të decentralizuar.

Sipas komponentës së parë të projektit, DEMOS III synon të hapë të dhënat për një shqyrtim më të gjerë publik mbi performancën komunale dhe të iniciojë auditime sociale për të monitoruar ndikimin e projekteve të Grantit të Performancës Komunale (GPK) tek qytetarët. Qëllimi i kësaj ndërhyrjeje është të përfshijë organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët në kryerjen e auditimeve sociale për të monitoruar projektet e Grantit të Performancës Komunale (GPK) të zbatuar nga komunat.

Për të zbutur rreziqet e besueshmërisë së fondeve të Grantit të Performancës, dhe njëkohësisht për të monitoruar ndikimin e projekteve tek qytetarët, DEMOS ka vendosur auditime sociale brenda Grantit të Performancës Komunale (në sistem). Auditimet sociale do të përfshijnë edhe monitorimin e performancës dhe procese të planifikimit të projekteve në nivel komunal. Projekti do të mbështes zhvillimin e mjeteve dhe metodologjive të kampionimit, duke përfshirë trajnime për të kryer me sukses auditime të tilla sociale. Auditimet Sociale të lartpërmendura do të financohen nga një pjesë e fondeve të Grantit të Performancës Komunale dhe do të zhvillohen nga organizata të shoqërisë civile. Për këtë, DEMOS do të jetë partner me OSHC-të kryesore.

BIRN Kosova është një organizatë e pavarur, joqeveritare, qëllimet e së cilës janë informimi i qytetarëve dhe kontributi në procesin e tranzicionit demokratik në vend, promovimi i llogaridhënies, sundimi i ligjit dhe reforma e politikave. BIRN Kosova në veçanti synon të shërbejë si mbikëqyrës i institucioneve publike, duke monitoruar punën e institucioneve qeverisëse dhe publike. Përveç kësaj, përmes prodhimit të debateve televizive cilësore dhe të paanshme dhe trajnimit të të rinjve mbi aftësitë argumentuese dhe debatuese, BIRN synon të promovojë dhe inkurajojë një kulturë të debatit në Kosovë. Vizioni i BIRN është të sigurojë pozicionin e saj si organizata kryesore e gazetarisë hulumtuese në Kosovë, duke adresuar nevojën për raportim objektiv, cilësor dhe të qëndrueshëm mbi sfidat e shumta të vendit. BIRN Kosova është angazhuar nga DEMOS për të bërë lehtësimin/fasilitimin e procesit të Auditimit Social në pesë projektet e përgjdhura në Drenas, Suharekë, Kaçanik, Han të Elezit dhe Viti.

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhja ekzekutive	6
Metodologjia	10
Harta e punëve	13
Ambienti në të cilin zhvillohet procesi i Auditimit Social	14
Kapitulli I - Gjetjet në procesin e konsultimeve me qytetarët	16
Dominimi i burrave në takimet publike	16
Performanca e moderatorëve të takimeve	17
Mungesa e diskutimit për projektin	17
Mungesa e publicitetit të dokumentacionit	17
Qytetarët e panjoftuar për mbikëqyrësin e projektit	18
Kapitulli II - Gjetjet në procesin e planifikimit	19
Projektimi problematik i thellësisë	19
Mungesa e koordinimit	19
Ndikimi në projektet e tjera	20
Projekti i kolektorit i papërfunduar	20
Ndikimi në ambient	20
Kapitulli III - Gjetjet në fazën e kontraktimit	21
Kapitulli IV - Gjetjet në implementimin e kontratës	23
Vonesat për shkak të koordinimit	23
Shtimi i kostos për shkak të nivelit qendror	23
Dëmtimi i infrastrukturës nga investimet në projekt	24
Siguria e vendpunishtes	25
Përfundime/rekomandime	25
Letra e kryetarit të Komunës së Drenasit	28
Letra e ekipit të Auditimit Social në Komunën e Drenasit	29
Ekipi i Auditimit Social në Drenas	30

Përmbledhja ekzekutive

Në vitin 2022, ekipi i projektit DEMOS realizoi programin për rritjen e kapaciteteve tek një grup i aktivistëve të shoqërisë civile, për të rritur kapacitetet e tyre për të lehtësuar procesin e Auditimit Social në komunitet.

Si koncept i ri në Kosovë, Auditimi Social nisi të implementohet nga DEMOS dhe Organizata të Shoqërisë Civile në vitin 2022, ndërsa raportet e para të publikuara gjatë atij viti mundësuan ndryshime konkrete në projektet e audituara.

Kush e financon Auditimin Social?

Puna në ekipet e Auditimit Social është punë vullnetare dhe nuk kërkon pagesë për anëtarët e grupit. Ekipet mund të kërkojnë mbështetje për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit apo vizitave nga donatorët e pavarur.

Në vazhdim të këtij programi, ekipi i BIRN i trajnuar nga DEMOS në mesin e vitit 2023 nisi realizimin e programit për krijimin e pesë ekipeve të Auditimit Social në pesë komuna të ndryshme.

Në kuadër të këtij procesi, një grup i qytetarëve nga Drenasi u përshinë për disa muaj në mbikëqyrjen e punimeve në projektin “Ndërtimi e kolektorëve për grumbullimin e ujërave të zeza në Komunën e Drenasit”. Grupi themeloi ekipin e “Auditimit Social” dhe nisi zbatimin e metodologjisë, për të analizuar dhe mbikëqyrur projektin i cili ishte në fazën finale të implementimit. Një nga detyrat e tyre ishte analizimi i procesit të takimeve dhe konsultimeve publike në Komunën e Drenasit dhe procesin e transparencës.

Ekipi i Auditimit Social

Ekipet e Auditimit Social janë grupe të qytetarëve, të cilët mblidhen me qëllim që të angazhohen në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike. Grupet vullnetare analizojnë procese me qëllim të ofrimit të rekomandimeve dhe përfshirjes më të madhe të qytetarëve në vendimmarrje.

Ky raport paraqet të dhëna të grumbulluara nga ekipi në mes muajve korrik dhe nëntor 2023. Duke përdorur metodologjinë e paracaktuar, ekipi arriti në konstatimin se:

- Projekti i ndërtimit të kolektorit të ujërave të zeza është jetik për Drenasin.
- Projekti nisi pa koordinim ndërinsitucional për shkak se mungonte leja mjedisore nga ministria dhe nuk kishte koordinim me ndërmarrjen Ibër-Lepenci.
- Projekti u përball me vonesa gjatë realizimit pasi kompania gjatë punës hasi në gypa të Ibër-Lepencit dhe është dashur të presin për rreth dy javë ekipin e tyre për të ndërhyrë.
- Projekti ka një ndikim të lartë në ambient dhe në ruajtjen e ujërave të pastërta të zonës.
- Projekti grumbullon ujërat e zeza nga fshatrat Shtrubullova, Poklek i Ri, Poklek i Vjetër dhe të njëjtat derdhen në një pjesë të fshatit Poklek i Vjetër. Projekti ka ndikim negativ për banorët pasi është shtuar kundërmimi i ujërave të zeza.
- Ekipi nuk ka hasur/konstatuar shkelje në procesin e prokurimit për përzgjedhjen e kompanisë implementuese të projektit.
- Projekti është realizuar me kohë dhe duke e respektuar Planin Dinamik dhe pa vonesa në kryerjen e punëve.
- Kontraktori ishte obliguar të gërmojë më thellë se sa ishte planifikuar në projekt. Komuna është arsytuar se projekti është projektuar para pastrimit të shtratit të lumit, dhe me pastrimin e shtratit të lumit është rritur lartësia e bankinës, e cila ka ndikuar në kuotat e projektit.
- Për shkak se kanalet janë bërë më thellë se sa në kontratw, Komuna u obligua të paguante para shtesë.
- Në mungesë të koordinimit me Ministrinë e Mjedisit nuk u mundësua kalimi i kolektorit në trasenë e rrugës dhe si rrjedhojë u kryen investime shtesë.
- Investimet nuk e kanë përmbushur në plotni nevojën e komunitetit pasi çështja e ujërave të zeza në Drenas kërkon edhe investime të tjera në të ardhmen.
- Punimet në zonë kanë lënë prapa hapësira të dëmtuara, të cilat kanë nevojë për investime të tjera. Por, komuna është zotuar se në planifikim afatgjatë ka planifikuar rregullimin rreth shtrati të lumit me shtigje për ecje dhe biçikleta.
- Gjatë realizimit të projektit ekipi ka gjetur se hapësirat nuk ishin të siguruara në përputhje me ligjet në fuqi për sigurimin e punëtorëve dhe vendpunishtet.
- Pas përfundimit të projektit në fshatin Poklek i Vjetër, ekipi ka identifikuar një gropë që është lënë e hapur gjatë realizimit të punimeve dhe e cila paraqet rrezik për qytetarët.
- Edhe pse në projekt nuk ishte paraparë, kontraktori dhe komuna kanë vendosur t'i mbulojnë disa prej tyre me arsytimin se ishte kërkesë e banorëve.

Çka duhet të dijë një ekip i Auditimit Social?

Ekipet e Auditimit Social nuk nevojitet të jenë shkajshmërisht profesionale. Ekipet kanë nevojë për vullnet dhe guxim qytetar si dhe rekomandohet të kenë njohuritë bazike në:

- Funksonimin e komunës;
- Qasjen në dokumente publike;
- Procesin e konsultimit me publikun, sidomos gjatë planifikimit të buxhetit dhe investimeve në komunë;
- Procesin e prokurimit publik;

Një fokus i veçantë i është kushtuar edhe transparencës dhe publicitetit të projektit në raport me qytetarët. Ekipi ka konstatuar se:

- Komuna e Drenasit nuk ka realizuar diskutim të veçantë publik për projektin e kolektorit.
- Komuna kishte publikuar kontratën e nënshkruar në mes komunës dhe kompanisë ndërtuese. Materiali i publikuar ofronte të dhëna për investimin dhe llojet e materialeve.
- Komuna nuk i kishte publikuar në mënyrë proaktive dokumentet e tjera, raportet e mbikëqyrjes apo faturat e pagesave nuk janë publike në faqen e komunës.
- Në faqen e komunës nuk ishte publik projektin ekzekutiv i projektit.
- Ekipi i Auditimit Social arriti ta sigurojë projektin ekzekutiv pas dërgimit të kërkesave për qasje në dokumente publike.
- Në tabelën e shpalljes së projektit, Komuna e Drenasit nuk i kishte njoftuar qytetarët për emrin e mbikqyrësit të projektit dhe kontaktet e tij por komuna e ka bërë publike emrin në faqen e komunës.

Një fokus i veçantë në Drenas i është kushtuar edhe procesit të takimeve dhe konsultimeve publike me qytetarët. Ekipi i Auditimit Social në Drenas trajtoi edhe angazhimin e komunës në mbajtjen e takimeve publike dhe adresimin e kërkesave të tyre. Ekipi konstatoi se:

- Qytetarët e Drenasit për një kohë kishin probleme për t'u qasur në materialet e konsultimeve dhe takimeve publike për shkak se faqja e komunës e menaxhuar nga qeveria kishte probleme teknike.
- Komuna e Drenasit bën përpjekje serioze për të përfshirë qytetarët në konsultime publike.
- Komuna përdor rrjetet sociale dhe platformat e tjera për t'i ftuar qytetarët në konsultime publike.
- Në diskutimet publike dominojnë kërkesat infrastrukturure dhe në pjesën më të madhe ato paraqiten si kërkesa individuale.
- Qytetarët kanë pak informacione për fatin e kërkesave të parashtruara në vitet e kaluara.
- Dokumentimi i takimeve publike realizohet nëpërmjet procesverbaleve të shkurtra, të cilat nuk e paraqesin në tërësi përmbajtjen e takimit.

Metodologjia

Ky raport paraqet të dhëna të grumbulluara nga intervistat, kërkesat për qasje në dokumente publike, vizitat në terren dhe bisedat me komunitetin. Në fillim të muajit maj, një ekip nga DEMOS dhe BIRN duke u bazuar në standarde të paracaktuara përzgjodhi 5 projekte në 5 komuna të Kosovës, të cilat do të përfshiheshin në procesin e Auditimit Social.

Kush e themelon ekipin e Auditimit Social?

Ekipet e Auditimit Social janë të pavarura nga institucionet dhe mund të themelohen nga përfaqësues të komunitetit por edhe grupe të tjera. Ekipet funksionojnë të pavarura nga qeverisja dhe nuk nevojitet miratim nga institucionet publike për themelimin e tyre.

Granti i Performancës Komunale në vitin 2022 financoi 57 projekte në 15 komuna të vendit. Në nisje të vlerësimit, ekipi përjashtoi nga përzgjedhja 4 komuna pasi të njëjtat ishin përfshirë në vitin e kaluar në një projekt të ngjashëm të Auditimit Social. Në 11 komunat e tjera BIRN realizoi vizita në terren për të parë gjendjen dhe për kërkuar informacione për fazat në të cilat ndodheshin projektet. Pas pranimit të raportit nga terreni, ekipi i DEMOS dhe BIRN i vlerësoi projektet bazuar në këto kritere:

- Statusi i projektit (nëse është në përfundim, mbi 50% e punëve janë të përfunduara, apo është në fazën fillestare);
- Targetimi dhe ndikimi i lartë apo i ulët i projekteve për grupet e marginalizuara si gratë, të rinjtë, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe komunitetet joshumicë;
- Natyra e projektit dhe fusha e ndikimit me prioritet në fushat e arsimit, shëndetësisë dhe ambientit;
- Vlera e grantit e alokuar për realizimin e projektit kapital.

Mbi bazën e këtyre kritereve u vendos që në komunën e Hanit të Elezit të auditohet projekti për ndërtimin e parkut “Isa Berisha”, në komunën e Drenasit projekti për ndërtimin e kolektorit për ujërat e zeza, në Kaçanik projekti për ndërtimin e objektit të zjarrfikësve, në Suharekë projekti për ndërtimin e shtegut të ecjes dhe ndërtimin e rrugës Mushtisht – Guri i Matozit dhe rrugës Topliqan – Gjinoc dhe në Komunën e Vitisë projekti për renovimin dhe zgjerimin e rrugës “Kongresi i Manastirit”.

Kush e themeloi grupin e Auditimit Social në Drenas?

Konform një metodologjie të përcaktuar, BIRN hartoi një listë me përfaqëses dhe profesione të cilat duhet të ftoheshin në grupet e Auditimit Social. Në kriteret e përzgjedhjes u përcaktuan se grupi synonte të përfshinte gratë dhe kategoritë e marginalizuara. Grupi synohej të kishte laramani të profesioneve dhe moshave.

BIRN dorëzoi te ekipi i DEMOS listën tentative me profesionet që duhet të përfshiheshin ndërsa pas koordinimit BIRN kontaktoi me qytetarët e Drenasit për të siguruar që kategoritë e përcaktuara të përfshiheshin në ekip.

Ekipi gjatë procesit konstatoi se Komuna e Drenasit nga Granti i Performancës komunale kishte përfituar pesë projekte:

- Ndërtimi i kolektorëve për grumbullimin e ujërave të zeza, Dobroshec - Drenas
- Rehabilitimi dhe rikonstruimi i rrugëve të asfaltuara në Drenas
- Rehabilitimi dhe rikonstruimi i rrjetit të kanalizimeve në Komunën e Drenasit
- Rregullimi i infrastrukturës, trotuarit dhe ndriçimit publik në Komunën e Drenasit
- Ndërtimi i infrastrukturës (Asfaltim dhe kubëzim) Drenas I II III dhe IV

Si rrjedhojë, ekipi vlerësoi se nga pesë projektet, projekti për ndërtimin e kolektorëve për grumbullimin e ujërave të zeza Dobroshec - Drenas ishte projekt madhor me ndikim të lartë në ambient dhe me rëndësi të lartë shoqërore.

Pas përzgjedhjes së projekteve, DEMOS dhe BIRN morën letra përkrahëse nga kryetarët e pesë komunave për nisjen e procesit të Auditimit Social për projektin. Për këtë raport ekipi i themeluar i Auditimit Social përdori disa teknika për të grumbulluar të dhënat.



Ekipi u angazhua për të kërkuar online të dhënat publike të komunës, hartoi një listë me mbi 50 pyetje për projektin dhe kërkoi informacione nga komuna, dërgoi kërkesa për qasje në dokumente publike dhe analizoi dokumentet e pranuar nga Komuna. Për të dokumentuar gjetjet, ekipi realizoi vizita në terren dhe zhvilloi takime me zyrtarët e Komunës së Drenasit, përfaqësuesit e komunitetit dhe kompanive implementuese.

Kush janë anëtarët e ekipit të Auditimit Social?

Anëtarët e ekipeve të Auditimit Social janë pjesëtarë të komunitetit, të cilët nuk janë në konflikt të interesit me projektin. Në ekipe nuk mund të jenë zyrtarët e institucionit të lidhur direkt me projektin dhe me procesin e mbikëqyrjes zyrtare të projektit.

Të dhënat në raport janë grumbulluar nga 20 anëtarët e ekipit të Auditimit Social dhe raporti është hartuar me ndihmën dhe mbështetjen e ekipit të BIRN. Raporti është bërë publik pas adresimit të komenteve të pranuar nga Komuna e Drenasit.

Përbërja e ekipit: 20 anëtarë



10 gra ose 50%



10 burra ose 50%

- Pensionistë
- Aktivistë
- Ambientalistë
- Administrator të fshatrave
- Ish-pjesëtar i FSK-së
- Elektracistë
- Bujq
- Njohës të ndërtimtarisë
- Pronare biznesesh
- Zjarrfikës

Harta e punëve

Qershor 2023

- Vizita në terren
- Targetimi dhe identifikimi i profileve që do të jenë pjesë e ekipit
- Përgatitja e listës me profilet e anëtarët të ekipit të Auditimit Social
- Zgjedhja e anëtarëve të ekipit të Auditimit Social

Korrik 2023

- Trajnimi dyditor për Auditim Social
- Krijimi i grupit në platformën e komunikimit Viber
- Caktimi i personave brenda ekipit për dërgimin e kërkesave në Komunë
- Nënshkrimi i Memorandimit të Mirëkuptimit me Komunën e Drenasit
- Hartimi i kërkesave për qasje në dokumente publike
- Vizita në terren nga anëtarët e ekipit të Auditimit Social
- Kontrollimi i materialeve të qasshme në platformat e hapura

Gusht 2023

- Pranimi i dokumenteve publike
- Analizimi i dokumenteve me anëtarët e grupit
- Takim i ekipit për të analizuar procesverbalet e konsultimeve publike
- Takim i ekipit për analizimin e dokumenteve të prokurimit
- Takim i grupit për analizimin e projektit
- Takim i grupit me menaxherin e projektit
- Vizita e grupit në vendpunishte dhe takimi me përfaqësuesit e kompanisë
- Vizita e ekipit në terren me Komisionin e pranimi teknik

Shtator 2023

- Analizimi i raporteve të mbikëqyrjes së punimeve
- Analizimi i materialeve nga konsultimet publike
- Konsultime grupore për problemet e identifikuara

Tetor 2023

- Takimi i ekipit për analizimin e të gjitha dokumenteve të pranuar
- Evidentimi i gjetjeve nga ekipi i Auditimit Social
- Ndarja e detyrave për ekipin në draftimin e raportit
- Vendosja e strukturës dhe përcaktimi i pikave të shkrimit të raportit
- Përcaktimi i detyrave për shkrimin e raportit

Nëntor 2023

- Draftimi i raportit mbi gjetjet dhe rekomandimet e ekipit të Auditimit Social
- Redaktimi i raportit
- Adresimi i komenteve dhe sugjerimeve

Dhjetor 2023

- Dërgimi i raportit për validim në komunë
- Prezantimi i raportit para zyrtarëve të komunës
- Realizimi i fushatës mediale për promovimin e raportit

Ambienti në të cilin zhvillohet procesi i Auditimit Social

Drenasi është komunë me madhësi mesatare me rreth 67 mijë banorë. Buxheti i komunës është mbi 18 milionë euro dhe fondet që shtohen në buxhet nga Granti i Performancës Komunale janë me ndikim të lartë në komunë.

Drenasi për disa vite ka arritur të jetë ndër përfituesit më të mëdhenj të Grantit të Performancës Komunale. Komuna arriti që të jetë në krye të listës duke u vlerësuar për menaxhimin e komunës dhe duke përfituar për vitin 2022 pesë projekte nga Granti i Performancës. Komuna përfitoi nga grantin prej 905,812 euro, i cili u financua nga DEMOS.

Granti i Performancës Komunale

Granti i Performancës Komunale është një fond i cili u ndahet komunave që kanë qeverisur mirë. Në vitin 2022, nga ky grant kanë përfituar 14 komuna për shkak të qeverisjes së mirë. Granti financohet nga BE, Qeveria e Zvicrës, Suedisë dhe Norvegjisë. Në vitin 2022, komunat kanë përfituar rreth 8 milionë euro nga Granti i Performancës Komunale. Projekti menaxhohet nga Helvetas Swiss Intercooperation Kosovo.

Komuna vendosi të investojë paratë e Grantit të Performancës Komunale në projektin e ndërtimit të kolektorit të ujërave të zeza. Kolektori i ujërave të zeza është një projekt madhor që synon të shtrihet në shumicën e fshatrave të Drenasit, kah kalon lumi Drenica. Përmes këtij projekti u financua rregullimi i kolektorit në tre kilometra gjatësi, i cili ka prekur dy zona kadastrale, Drenasin dhe Poklekun. Projekti pritet të vazhdojë në vitet e tjera për të arritur cakun e tij final, në Dobroshec.

Lumi Drenica është njëri nga lumenjtë e Kosovës i cili për një kohë të gjatë vlerësohej si lum i pastër dhe potencial për zonën. Ndërtimet rreth lumit dhe zhvillimi i ekonomisë ndikuan që lumi të niste ndotjen. Ujërat e zonës derdhen në lum duke ndikuar seriozisht në ndotjen e ujërave të pastërta.

Projekti i ndërtimit të kolektorit synon të largojë ujërat e zeza nga ujërat e pastërta dhe të krijojë një zonë të pastër. Përmes këtij projekti, ujërat e zeza synohet të largohen nga zona dhe synohet të dërgohen ato në një impiant të trajtimit të ujërave të zeza, i cili pritet të ndërtohet në të ardhmen.

Kanalizimi dhe ndotja e lumit janë me pasoja për banorët e zonës. Në hapësirat rreth lumit Drenica qytetarët kanë zhvilluar aktivitete bujqësore dhe ujitja e tyre është realizuar edhe nga uji i lumit. Projekti ndikon në pastrimin e ujërave dhe si rrjedhojë do ketë impakt edhe në zhvillimin e bujqësisë së pastër.

Gjetjet kryesore

Gjatë procesit të Auditimit Social, grupi i Drenasit trajtoi disa tema, mbi të cilat arriti të nxjerrë përfundime. Gjetjet janë grupuar në katër kategori duke i argumentuar të njëjtat me gjetjet në dokumentacion dhe në kategori.

Çka ndikon Auditimi Social?

Procesi i Auditimit Social në Komunën e Drenasit ndikoi në përmirësimin e dëmeve të cilat u shkaktuan nga punimet gjatë realizimit të projektit. Ekipi i kërkoi komunës që të rregullohej shtrati i lumit në zonën e dëmtuar nga punimet.

Grupimi i gjetjeve është realizuar bazuar në fokusin e hulumtimit dhe përfshirjes së qytetarëve në këtë proces.

- Gjetjet në procesin e konsultimeve me qytetarët
- Gjetjet në procesin e planifikimit
- Gjetjet në fazën e kontraktimit
- Gjetjet në implementimin e kontratës

Kapitulli I - Gjetjet në procesin e konsultimeve me qytetarët

Drenasi ka rreth 67 mijë banorë. Komuna e Drenasit brenda vitit konsulton qytetarët duke përdorur teknika të ndryshme, duke përfshirë takimet direkte me qytetarët dhe konsultimet formale publike. Në analizimin fillestar është konstatuar se Komuna ka mbajtur takime dhe konsultime publike dhe materialet i ka publikuar në faqen zyrtare. Ekipi ka analizuar procesverbalet dhe dokumentet e siguruara nga komuna, të cilat kanë dalë gjatë këtyre proceseve.

Grupi ka konstatuar se komuna në tre vite ka mbajtur numër të madh të takimeve publike me qytetarë dhe ka synuar të përfshijë ata në këto takime. Takimet janë realizuar në ambiente të afërta me qytetarët, duke u përdorur shkolla dhe hapësira publike në fshatra dhe lagje për të shkurtuar rrugën e qytetarëve.

Dominimi i burrave në takimet publike

Gjatë analizimit të procesverbaleve të konsultimeve publike, grupi ka konstatuar se pjesëmarrja në takime vazhdon të dominohet nga burrat ndërsa kërkesat e komunitetit vazhdojnë të jenë kryesisht për investime në infrastrukturë.

Po ashtu, grupi ka gjetur se komuna nuk e ka paraqitur të gjithë përmbajtjen e takimeve në procesverbale, pasi kërkesat e qytetarëve janë përshkruar shumë shkurt dhe pa ndonjë arsyeshmëri se pse të njëjtat duhet të realizohen. Zakonisht kërkesat i janë atribuar një personi pa u konfirmuar se kërkesa është paraqitur apo mbështetur edhe nga qytetarët e tjerë që kanë marrë pjesë në takim.

Në procesverbalet e konsultimeve publike në Drenas, grupi ka gjetur se përfaqësimi i komunës në takime ka qenë zakonisht me zyrtarë të lartë, kryesisht kryetari, drejtorët apo nënkryetari. Praktika e Drenasit tregon se në hyrje të takimeve, qytetarëve u është dhënë lista me planin për investime në atë zonë dhe detajet e tjera për takimin. Grupi i Auditimit Social ka analizuar këtë praktikë duke konstatuar se është praktikë e mirë dhe u ofron qytetarëve informacione. Mirëpo në procesverbale nuk është evidentuar se komuna u ka ofruar përgjigje qytetarëve për kërkesat e adresuara nga viti i kaluar. Si rrjedhojë grupi ka konstatuar se në mungesë të këtij informacioni qytetarët mbesin pa përgjigje për kërkesat nga vitet paraprake. Grupi e ka parë të nevojshme që në takimet e radhës komuna t'i njoftojë qytetarët edhe për fatin e kërkesave të tyre në të kaluarën.

Performanca e moderatorëve të takimeve

Gjatë analizimit të procesvebaleve grupi ka konstatuar se në Drenas ka pasur debate dhe përgjigje nga zyrtarët e komunës për qytetarët por ajo çka ekipi e ka evidentuar është mungesa e nismës për të hapur debate të reja. Ekipi i Auditimit Social ka ardhur në përfundim se moderatorët e takimeve të diskutimeve publike nuk arrijnë të provokojnë debate dhe të shtrojnë pyetje për komunitetin për nevojat e tyre. Sidomos në zona rurale, moderatorët duhet të jenë proaktiv dhe të provokojnë komunitetin nëse iu nevojiten investime të caktuara.

Roli i moderatorëve në diskutimet publike

Roli i moderatorëve në diskutimet publike duhet të jetë më proaktiv. Moderatorët duhet të nxisin përfshirjen e qytetarëve në diskutime për projektet komunale dhe për buxhetin. Ata duhet të provokojnë debat dhe të nxjerrin ide e propozime nga qytetarët pjesëmarrës.

Mungesa e diskutimit për projektin

Ekipi ka gjetur se projekti ishte kërkesë e qytetarëve dhe nevojë e tyre. Ekipi ka kontrolluar nëse për projektin në fjalë ishte mbajtur një diskutim publik me qytetarët e zonës. Komuna ka konfirmuar se një takim i tillë nuk është mbajtur dhe nuk ka pasur prezantim të projektit tek banorët. Ekipi ka vlerësuar se në projekte të tilla të cilat kanë shtrirje të gjatë, banorët duhet të jenë të njoftuar për shkak të ndikimit të projekteve në jetën dhe përditshmërinë e tyre.

Mungesa e publicitetit të dokumentacionit

Kontrata e projektit, e nënshkruar mes komunës dhe kompanisë ndërtuese ishte publikuar në faqen e komunës. Gjatë analizimit të dokumenteve është vërejtur se projekti ekzekutiv për ndërtimin e kolektorëve për grumbullimin e ujërave të zeza në Komunën e Drenasit nuk është publikuar në platformën elektronike për prokurim publik “e-prokurimi”. Dokumenti u siguruara me kërkesë për qasje në dokumente publike.

Ekipi po ashtu konstatoi se Komuna nuk i kishte publikuar në mënyrë proaktive dokumentet e tjera, si raportet e mbikëqyrjes apo faturat e pagesave nuk janë publike në faqen e komunës. Materialet u bënë të qasshme për ekipin pas kërkesave për qasje në dokumente publike.

Qytetarët e panjoftuar për mbikëqyrësin e projektit

Një element të rëndësishëm që ekipi gjeti është fakti se qytetarët e zonës nuk kishin njohuri se kush ishte mbikëqyrësi i projektit. Grupi konstatoi se qytetarët nuk janë në dijeni se kush është menaxheri i kontratës e cila po implementohet në lagjen apo qytetin e tyre. Tabela me detajet e projektit nuk e përmbante një informacion të tillë ndërsa në faqen e komunës ishte vendosur emri i mbikëqyrësit. Në mënyrë që qytetarët të jenë në dijeni të këtij fakti, ekipi rekomandon që në tabelën që vendoset me fillimin e implementimit të projekteve, të vendoset edhe emri, mbiemri dhe kontakti i menaxherit të kontratës, në mënyrë që qytetarët të jenë në dijeni se kush është personi që mund t'i drejtohen për ndonjë kërkesë, ankesë apo edhe t'i japin ndonjë informacion.

Mbikëqyrësi i kontratës

Mbikëqyrësi i kontratës është një person apo kompani e angazhuar nga komuna. Ai është përgjegjës për të mbikëqyrur secilën fazë të implementimit të kontratës. Mbikëqyrësi harton raporte për secilën fazë.

Mbikëqyrësi është një zyrtar i rëndësishëm tek i cili mund të raportohet çdo problem dhe parregullsi në projekte të caktuara. Ekipi konstatoi se në faqen e Komunës së Drenasit është vendosur emri e zyrtarëve të komunës që janë të përfshirë në mbikëqyrjen e projekteve. Pas kërkesës ekipi arriti të gjente emrin e mbikëqyrësit të kontratës dhe diskutimet me të ndihmuan ekipin për të kuptuar më drejtë dhe më qartë procesin e implementimit të projektit.

Kapitulli II - Gjetjet në procesin e planifikimit

Grupi i Auditimit Social analizoi edhe procesin e projektimit të ndërtimit të kolektorit, duke nxjerrë disa mësimet dhe rekomandime. Projektin për ndërtimin e kolektorit për grumbullimin e ujërave të zeza në Drenas e ka hartuar Studio Hapësira SHPK, kjo pasi Komuna e Drenasit nuk ka resurse për të hartuar projekte të tilla.

Projektimi problematik i thellësisë

Për shkak të projektimit të gabuar, Komuna e Drenasit ishte e detyruar të nënshkruajë aneks-kontratë për punë shtesë. Gjatë vizitave në terren dhe pas analizimit të dokumentacionit rezultoi që niveli i projektuar i gërmimit të kanalit kryesor ishte bërë gabimisht.

Gypat e kanalizimit që ishin vendosur shumë kohë më parë kanë qenë më në thellësi se sa kolektori i ri, përkatësisht gypat që vijnë nga Komorani kanë qenë 1 metër më thellë sesa kolektori i ri i planifikuar. Komuna është obliguar që të rris thellësinë e vendosjes së kolektorit. Ky gabim dhe nevoja që të rritet thellësia e vendosjes së kolektorit ka bërë që të rritet vëllimi i dheut të gëmuar, sasia e zhavorrit si dhe të rritet thellësia e pusëve. Kjo ishte një nga arsytet që Komuna e Drenasit ka nënshkruar aneks-kontratën për punë shtesë në vlerë prej 68 mijë eurove.

Mungesa e koordinimit

Një problem tjetër në projektim dhe koordinim ishte plani që kolektori të kalonte në rrugën magjistrale Drenas-Skenderaj. Komuna dhe punëkryesi kishin propozuar që të prehej rruga rajonale Drenas - Skenderaj, mirëpo nuk kishin arritur të sigurojnë lejet e nevojshme nga Ministria e Infrastrukturës, nën menaxhimin e të cilës është kjo rrugë.

Më 12 qershor 2023, Komuna e Drenasit e kishte dërguar kërkesën te Ministria e Mjedisit, përkatësisht te Departamenti i rrugëve dhe ministri Liburn Aliu për t'ia mundësuar që prerjen e asfaltit, në mënyrë që të vendoset tubi me diametër prej 1200 mm. Edhe pse kërkesa ishte dërguar dy muaj para se të nënshkruhej kontrata nga Komuna e Drenasit, ministria nuk ishte përgjigjur. Ekipi konstatoi se një leje e tillë nuk u ofrua dhe projekti u devijua për të arritur qëllimin e tij. Për devijimin u nevojitën të paguheshin para shtesë.

Në fushën e projektimit grupi gjeti edhe sfida të tjera. Për shkak të mungesës së hartave dhe informacioneve për shtrirjen e infrastrukturës, projektuesi nuk e kishte identifikuar se projekti kalonte afër sistemit të Ibër-Lepencit. Si rrjedhojë punimet në projekt ngecën për dy javë deri në kohën kur ndërmarrja Ibër-Lepenci ndërhyri për të mundësuar shtrimin e rrjetit.

Ndikimi në projektet e tjera

Grupi i Auditimit Social konstatoi se projekti preku edhe investimet e kryera në shtratin e lumit Drenica. Në hyrje të qytetit të Drenasit, një pjesë e shtratit me gurë u desh të prishej për t'i lënë rrugë shtrimit të kolektorit. Komuna duhet të investojë para shtesë për të përmirësuar prishjet nga kjo ndërhyrje.

Projekti i kolektorit i papërfunduar

Projekti i kolektorit është një projekt i madh dhe nuk është përmbushur në tërësi nga Granti i Performancës Komunale. Komuna do të obligohet që në vitet pasuese të investojë edhe disa kilometra të tjera për ta shtrirë kolektorin deri në fshatin Dobroshec.

Grupi arriti në përfundim se investimi nuk arrin t'i përmbushë të gjitha nevojat e zonës për disa arsye. Investimi në fjalë ka shtuar trasenë e kolektorit për 1.5 kilometra mirëpo traseja e shkurtër krijon probleme për banorët e një pjese të fshatit Poklek i Vjetër dhe një pjesë të fshatit Shtrubullova, ku derdhen ujërat e zeza. Grupi arriti në përfundimin se investimet e tjera duhet të fokusohen për të trajtuar këtë problematikë.

Ndikimi në ambient

Projekti është paraparë të ketë ndikim të mirë në ambient për shkak se pastron lumin. Mirëpo ekipi i Auditimit Social gjeti se zona në të cilën shtrihet projekti pati lëvizje të mëdha të dheut. Për këtë, komuna nuk ka një projekt të rivitalizimit, në të cilin përfshihet edhe mbledhja e drunjve apo barit.

Një banor i fshatit Poklek i Vjetër është ankuar se i është dëmtuar prona e tij bujqësore gjatë realizimit të projektit. Komuna ka formuar një Komision të vlerësimit të dëmit për t'ia kompensuar dëmin e pretenduar nga banori. Grupi nuk ka arritur të verifikojë nëse janë kompensuar të gjithë banorët, pronat e të cilëve janë dëmtuar gjatë realizimit të punimeve gjatë shtritjes së kolektorit.



Kapitulli III - Gjetjet në fazën e kontraktimit

Ekipi i Auditimit Social ka analizuar edhe procesin e kontraktimit të projektit. Në këtë fazë grupi ka gjetur se procesi i kontraktimit ka shkuar pa probleme dhe pa ankesa në organet kontraktuese. Megjithatë, ekipi ka gjetur se komuna është obliguar të nënshkruajë një kontratë për punë shtesë në këtë projekt për shkak të mosplanifikimit adekuat të punëve në projekt.

Njoftimi për kontratë për projektin “Ndërtimi i kolektoreve për grumbullimin e ujërave të zeza në Komunën e Drenasit - Projekt dy vjeçar” është publikuar më 13 korrik 2022 në faqen zyrtare të prokurimit. Vlera e parashikuar e projektit të kolektoreve për grumbullimin e ujërave të zeza në Komunën e Drenasit ka qenë 699 mijë euro. Sipas dosjes, afati i fundit për pranim të tenderëve ka qenë data 2 gusht 2022.

Ndaj njoftimit për kontratë i cili është i publikuar nga Komuna e Drenasit më 13 korrik 2022, është ankuar kompania “Diamanti Sh.p.k”, e cila kishte pretenduar se janë vendosur kriteret diskriminuese. Ankesa e kësaj kompanie është refuzuar nga Komuna e Drenasit me arsyetimin se nuk janë të bazuara pretendimet e kompanisë dhe se të gjitha kriteret janë parashtruar sipas natyrës së projektit, punimeve në terren dhe në harmoni me vlerën e projektit e cila është vlerë e madhe. Pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga Komuna e Drenasit, kompania ankuese nuk ishte ankuar fare në shkallën e dytë, në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

Për ndërtimin e kolektorit për grumbullimin e ujërave të zeza kishin ofertuar katër operatorë dhe grupe të operatorëve ekonomikë. Sipas procesverbalit të hapjes së tenderit, katër operatorë ekonomikë për ndërtimin e kolektorëve për grumbullimin e ujërave të zeza kanë paraqitur oferta me çmime të ndryshme.

1	LimitProject SHPK & Delta-CCD SHPK & Rinesa SHPK	693,353 €
2	Aksi Projekt SHPK	690,091 €
3	Valdrini SHPK	709,423 €
4	NNT Milazim Shala & Bujar Shabani B.I & EL Bau SHPK	644,424 €

Komuna e Drenasit e kishte rekomanduar për kontratë Grupin e operatorëve ekonomikë LimitProject SHPK & Delta-CCD SHPK & Rinesa SHPK, të cilët kishin ofertuar me një çmim prej 693,353 euro. Kjo nuk është kompania që ka ofertuar me çmimin më të ulët. Grupi i operatorëve ekonomikë NNT Milazim Shala & Bujar Shabani B.I & EL Bau SHPK ka ofertuar me çmimin më të ulët, përkatësisht me 48 mijë e 929 euro më pak se kompania fituese.



Arsyet e eliminimit të këtij grupi të operatorëve ekonomikë ishte sigurimi i tenderit, letër-përkrahja nga banka, lista e stafit të kompletuar nga grupi i operatorit ekonomik, një inxhinier i trajnuar për asbest dhe makineria për shpim horizontal nëntokësor me sistemin lazer të kontrollit me diameter DN250-DN1400. Kompanitë e eliminuara nga ky tender nuk kishin parashtruar kërkesë për rishqyrtim në Komunën e Drenasit apo ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

Kapitulli IV - Gjetjet në implementimin e kontratës

Komuna e Drenasit e ka caktuar Granit Karaqicën si menaxher të kontratës në vlerë prej 693,353 euro, e cila është lidhur me grupin e operatorëve ekonomikë LimitProject SHPK & Delta-CCD SHPK & Rinesa SHPK. Në kontratën e nënshkruar nuk është caktuar fare afati për kryerjen e punimeve, mirëpo është thënë se kohëzgjatja e punimeve do të përcaktohet në “Planin Dinamik” dhe “Planin për Menaxhimin e kontratës”.

Ekipi i Auditimit i ka bërë disa vizita në terren, gjatë kohës sa ishin duke u realizuar punë në hapjen e kanaleve apo vendosjen e gypave. Ekipi ka konstatuar se kompania në disa raste i ka mbuluar pusetat, e në disa raste ato kanë qenë mbi tokë. Kjo çështje është ngritur tek menaxheri i kontratës, Granit Karaqica dhe tek kryepunëtori i kompanisë implementuese që ka qenë në terren. Përfaqësuesi i OE-së ka thënë se kjo ka qenë kërkesë e qytetarëve. Ai ka thënë se ka raste kur banorët/pronarët e tokave kanë kërkuar që puseta mos të jetë e dukshme mbi tokë në mënyrë që t'i mundësohet atyre që të punojnë tokën lirshëm.

Vonesat për shkak të koordinimit

Po ashtu, menaxheri i kontratës ka përmendur përgjigjen e vonuar që kanë marrë nga kompania Ibër-Lepenci lidhur me gypat që janë hasur gjatë ndërtimit të kolektorit. Kompania gjatë punimeve kishte hasur në gypa të kompanisë Ibër-Lepenc pa i dëmtuar ata dhe e kishte lajmëruar Komunën, në mënyrë që të njëjtit të njoftojnë Ibër-Lepencin për të ndërhyrë. Sipas menaxherit të kontratës Granit Karaqica, kjo ka vonuar procesin e punimeve rreth tri javë deri sa kompania Ibër-Lepenc ka dërguar ekipin e tyre për të intervenuar. Gjithashtu nga Komuna kanë thënë se gjatë punimeve në këtë projekt, kompania kur ka hasur në gypat e ujësjellësit është dashur që të presin lejen nga Ministria e Mjedisit, pasi pjesa në afërsi të urës në hyrje të Drenasit menaxhohet nga ky dikaster.

Shtimi i kostos për shkak të nivelit qendror

Gjatë menaxhimit të kontratës, telashe dhe kosto shtesë ka shkaktuar edhe mungesa e koordinimit institucional për realizimin e këtij projekti. Përkundër që Komuna e Drenasit me kohë kishte kërkuar nga Ministria e Infrastrukturës lejen për prerjen e asfaltit në rrugën rajonale, kjo e fundit asnjëherë nuk ka kthyer përgjigje. Në dokumentet e menaxhimit të kontratës thuhet se ekipi ka gjetur një zgjidhje për realizim të projektit duke e devijuar kolektorin. Ky ndryshim ka bërë që të rritet gjatësia e gypit, të shtohen dy puseta të reja, të ketë punë betonuese shtesë për të përforcuar kolektorin, i cili ishte planifikuar të kalojë përmes urës. Kjo ka bërë që më 10 nëntor 2022, Komuna e Drenasit, të nënshkruajë një aneks-kontratë në vlerë prej 68,916 euro. Ligji i Prokurimit Publik lejon nënshkrimin e kontratave të tillë në rastet kur gjatë realizimit të projektit rezultohet me punë të paplanifikuara. Këto kontrata mund të shkojnë deri në 10% të vlerës së kontratës bazë.

Dëmtimi i infrastrukturës nga investimet në projekt

Kur është bërë intervenimi për hapjen e hapësirave rreth lumit për ndërtimin e kolektorit për ujërat e zeza te ura në hyrje të qytetit të Drenasit, janë larguar gurët dekorativë rreth shtratit të lumit Drenica, të cilët kanë qenë të vendosur më herët. Kjo është ngritur si çështje nga Grupi i Auditimit Social gjatë kohës që punimet kanë qenë në realizim e sipër. Grupi i Auditimit, pas vizitës së fundit, ka konstatuar se gurët dekorativë janë kthyer në vendin e tyre sipas kërkesës së banorëve. Banorët kanë konstatuar se punët në rikthimin e gurëve në shtratin e lumit nuk janë realizuar në cilësinë e duhur, pasi të njëjtit nuk janë kthyer siç kanë qenë para fillimit të projektit.

Në pjesën në të cilën ka përfunduar kolektori i ndërtuar me projektin aktual, ujërat e zeza përsëri derdhen në lum. Banorët që banojnë në atë pjesë janë ankuar për kundërmim të ujërave të zeza. Edhe banorët që kanë në pronësi toka bujqësore apo edhe bagëti janë ankuar për pamundësinë për ta shfrytëzuar ujin e lumit. Ekipi i Auditimit Social vlerëson që faza tjetër e ndërtimit të kolektorit të ujërave të zeza të fillojë sa më shpejtë në mënyrë që këto probleme të eliminohet por edhe kolektori të kryejë punën për të cilin është ndërtuar.

Banorët rekomandojnë që hapësira mbi të gjithë rrjedhën e lumit Drenica në të cilën është ndërtuar kolektori për ujëra të zeza, të shfrytëzohet për hapësira rekreative, të ndërtohen shtigje të ecjes, të vendosen ulëse, shporta të mbeturinave, të mbillen hapësira të gjelbëruara.

Siguria e vendpunishtes

Gjatë vizitave në terren ekipi i Auditimit Social ka kontrolluar edhe për aspektin e sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë implementimit të projektit investiv. Ekipi ka gjetur se kompania implementuese nuk ka vendosur rrethoja në vendpunishte, për të parandaluar qasjen e njerëzve të paautorizuar në zonën ku gërmohej deri në 3 metra.

Përgatitja dhe siguria e vendpunishtes është përgjegjësi e kompanive të cilat implementojnë punët në terren. Mirëpo në vizitat e realizuara ekipi ka konstatuar se zona në të cilin është implementuar projekti, nuk ka pasur asnjë masë mbrojtëse që do të parandalonte njerëzit dhe kafshët të futeshin në zonën në të cilën po punohej.

Komisioni për pranimin teknik

Komisioni për pranimin teknik është një ekip profesional i komunës, i cili në fund të projektit inspekton punimet dhe në bazë të raportit të këtij ekipi punët pranohen dhe kryhen pagesat.

Gjatë një vizite ekipi ka gjetur se në fshatin Poklek i Vjetër ka mbetur një gropë e hapur për shkak të ndërtimit të kolektorit. Kjo gropë e hapur paraqet rrezik për qytetarët, veçanërisht për fëmijët, pasi në atë pjesë nuk ka të vendosura tabela paralajmëruese. Ekipi i Auditimit Social rekomandoi vendosjen e sinjalistikës së përshtatshme dhe shiritit të sigurisë rreth gropës. Kjo çështje është ngritur nga ekipi edhe te Komisioni për Pranim Teknik. Ekipi i Auditimit Social ka kuptuar se pasi kanë ngritur këtë shqëtësim, kompania ka intervenuar duke vendosur shirit.

Ekipi ka gjetur po ashtu se punonjësit e kompanisë nuk bartnin mjete mbrojtëse.

Përfundime/rekomandime

Ekipi i Auditimit Social në fund të projektit ka analizuar punën dhe ka arritur në disa përfundime.

- Për shkak se Auditimi Social është kryer në përfundim të projektit, intervenimet e grupit kanë qenë të vogla në projektin aktual.
- Megjithatë si rezultat i punës së ekipit të Auditimit Social, komuna ka ndërmarrë veprime për të rregulluar shtratin e dëmtuar të lumit.

Çka ndodh me rekomandimet?

Rekomandimet e grupeve të Auditimit Social shërbejnë për përmirësimin e qeverisjes. Rekomandimet do të përdoren për përmirësim të projekteve të ardhshme dhe për përmirësimin e projektit aktual.

Ekipi ka arritur në përfundim se Komuna e Drenasit ka pasur vullnet dhe gatishmëri të bashkëpunojë me ekipin. Po ashtu ka treguar gatishmëri të adresojë çështjet e ngritura dhe të ofrojë informacione të bollshme për ekipin për të realizuar procesin e Auditimit Social. Në përfundim të procesit, ekipi ka hartuar një listë me rekomandime për Komunën e Drenasit.

Rekomandimet në përshirjen e qytetarëve:

- Komuna duhet të realizojë takime të veçanta me qytetarët për projekte madhore, në të cilat diskutohen projektet dhe plani i implementimit.
- Për të realizuar një proces të mbikëqyrjes qytetarare, komuna rekomandohet të publikojë më shumë dokumente rreth projekteve, duke përfshirë projektin dhe kontratën e plotë me operatorët ekonomikë.
- Komuna rekomandohet që edhe dokumente të tjera të prodhuara gjatë mbikëqyrjes së projekteve, si raportet e mbikëqyrësit apo raportet e pranimit teknik t'i bëjë publike për qytetarët.
- Komuna rekomandohet që në tabelat e shpalljeve të vendosë emrin e mbikëqyrësit e kontratës apo adresa ku qytetarët mund të dërgojnë informacione.
- Komuna rekomandohet që në faqen e saj në Facebook të promovojë emrat e personave të përfshirë në mbikëqyrjen e projekteve komunale.
- Në procesin e takimeve dhe konsultimeve me qytetarët, Komuna rekomandohet të avancojë agjendën e takimeve, duke u fokusuar që në nisje të ofrohen më shumë informacione se çka ka ndodhur me projektet e kërkuara në të kaluarën.

- Komuna rekomandohet që me programe të veçanta t'i trajnojë moderatorët e takimeve në mënyrë që të zhvillojnë kapacitetet e tyre për provokim të debatit dhe nxitje të temave dhe nxjerrjen e propozimeve për projekte të reja.
- Komuna rekomandohet që të ndryshojë procesin e dokumentimit të takimeve publike. Procesverbalet dhe raportet nga këto takime duhet të jenë më të detajuara dhe më gjithëpërfshirëse.
- Komuna rekomandohet që të nis përdorimin e platformave online për të përfshirë më shumë qytetarë në takimet e diskutimeve publike.

Rekomandimet për procesin e planifikimit:

- Të realizohet skenim i zonës në të cilin realizohet projekti për të evituar probleme si ai me thellësinë e kolektorit.
- Para projektimit, kompanitë duhet të kenë hartat dhe informacionet për infrastrukturën publike të vendosur në vendpunishte. Projektimi i investimeve duhet të ketë parasysh edhe rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë.
- Komuna duhet të sigurojë informacione të plota për projektuesit e projekteve, në mënyrë që projekti të jetë sa më i saktë.
- Në rastet kur projektimi është bërë gabim për faj të projektuesit, komuna duhet të marrë masa në përputhje me kontratën e nënshkruar.

Rekomandimet për procesin mbikëqyrjes:

- Mbikëqyrja e procesit të punimeve duhet të jetë më aktive dhe të parandalojë mundësi të dëmtimeve të ndryshme në projekt.
- Mbikëqyrësit duhet të evidentojnë dëmtimet para se të vjen fundi i projektit.
- Mbikëqyrësit duhet të evidentojnë në çdo rast kur kompania nuk po respekton rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë.
- Menaxheri i kontratës duhet të mbajë procesverbale pas secilës vizite dhe takim me kontraktorin.

Rekomandime për investime të reja në projekt:

Ekipi i Auditimit Social ka diskutuar dhe ka arritur në përfundim se në projektin e kolektorit duhet të vazhdohen investimet. Andaj grupi i rekomandon komunës që:

- Të vazhdohet projekti deri në kufirin e Drenasit me Fushë Kosovën.
- Të vazhdohet me ndërtimin e kanalizimeve lidhëse të fshatrave dhe zonave rreth kolektorit.
- Të vazhdohen investimet në rregullimin e shtratit të lumit.
- Të investohet në rigjenerimin e zonës dhe sanimin e dëmeve anësore të projektit.

Letra e kryetarit të Komunës së Drenasit

Vlerësoj lartë dhe falënderoj pjesëmarrjen dhe mbështetjen e komunitetit dhe akterëve tjerë në realizimin e projekteve tona.

Përgjegjësia dhe përkushtimi ynë për Auditim Social është i lidhur ngushtë me sigurimin e efikasitetit dhe përshtatshmërisë së programeve tona. Duke pasuar standarde të larta të përgjegjësisë shoqërore, ne angazhohemi për transparencë, llogaridhënie, barazi dhe mbështetje të vazhdueshme për të gjitha palët e interesuara.

Kemi një përgjegjësi ndaj mjedisit dhe shoqërisë, prandaj angazhohemi për të përmirësuar ndikimin pozitiv, nëpërmjet praktikave të mira, të qëndrueshme dhe inovative. Për ne, Auditimi Social është një mjet kyç për të kontribuar dhe siguruar një mjedis të drejtë dhe të qëndrueshëm.

Përkushtimi ynë ndaj transparencës dhe integritetit, në bashkëpunim me mediat si partner i rëndësishëm në këtë rrugë e po ashtu edhe Auditimi Social, do ta thellojnë akoma më shumë afërsinë me qytetarët dhe të inkurajojmë pjesëmarrjen aktive të tyre për raportim të ndërgjegjshëm rreth projekteve tona, në dobi të qytetarëve.

Ju faleminderit!



Letra e ekipit të Auditimit Social në Komunën e Drenasit

Për neve dhe qytetarët e tjerë të Drenasit, Auditimi Social ka qenë diçka e re dhe e paprovuar më parë. Ekipi ka mësuar së pari rëndësinë që e ka Auditimi Social dhe mbikëqyrja e projekteve që prekin qytetarët. Sepse deri tash kemi parë punëtorë afër pronave e shtëpiave tona duke punuar dhe nuk kemi qenë ndoshta të vetëdijshëm për me i monitoru dhe me kërkimi llogari se a po kryhen punimet sipas planit e në bazë të projektit.

Nga trajnimi dyditor që kemi mbajtur me përfaqësuesit e BIRN kemi kuptuar edhe procedurat e prokurimit, mënyrën e analizimit të dokumenteve dhe atë të dërgimit të kërkesave për qasje në dokumente në Komunë.

Ky projekt ka qenë një përvojë e mirë për të gjithë ne duke na vetëdijësuar edhe neve si qytetarë që të ndjehemi të lirë të kërkojmë llogari dhe transparencë të pushteti komunal dhe jo vetëm.



Ekipi i Auditimit Social në Drenas

Nr	Emri dhe mbiemri	Profesioni/Funksioni
1	Avni Miftari	Ambientalist
2	Afrim Gjeli	Administrator i fshatit Poklek i Ri / Shef i operativës së zjarrfikësve
3	Jakup Haxhiu	Pensionist/ E ka pronën në afërsi të kolektorit të ujërave të zeza
4	Shaqir Gashi	Pensionist/ Ka punuar në ndërtimtari
5	Fadil Prenku	I pensionuar nga FSK/Përfaqësues i fshatit Dobroshec
6	Imer Qerkini	Pensionist
7	Hamdi Fazliu	Elektracist
8	Hajrush Muslija	Bujk
9	Abedin Selmani	Bujk
10	Teuta Haxhiu	Letrare/E ka pronën në afërsi të kolektorit të ujërave të zeza
11	Zadrie Podrimqaku	Aktiviste
12	Zekë Kluna	Kryetar i fshatit Poklek të Vjetër / Murator
13	Halime Kuliqi	Pronare biznesi
14	Bahrije Kiqina	Pronare biznesi
15	Jehona Halilaj	Aktiviste
16	Selvete Ramadani	Amvise
17	Razije Uka	Amvise
18	Ganimete Halili	Pronare biznesi
19	Lutfie Hysenaj	Amvise
20	Mahije Smajli	Drejtoreshë e OJQ-s “Bliri” e cila avokon për të drejtat e grave



Co-funded by
the European Union



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sweden
Sverige



Norwegian Embassy